1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
(Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Loti i I-rë: "Blerje gazoil për automjete";

GAZOIL D I AL ST EN 590:2013+A1:2017

Tabela 1-kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provës për karburantet automotive

Substanca	Njësia matëse	Limitet (normat)		Metoda e provës (shih klauzolës 2)
		Minimum	Maksimumi	
Numri i Cetanit		51	-	EN ISO 5165 EN 15195 EN 16144
Indeksi Cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 gradë celcius	Kg/m ³	820,0	845,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarbure Polycyclic aromatike	% (m/m)	-	8,0	EN 12916
Përmbajtje squfuri	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846

				EN ISO 20884 EN ISO 13032
Përmbajtje Mangani Deri 31-12-2013 Nga 01.01.2014 në vazhdim	mg/l	- -	6,0 2,0	Pr EN 16576
Pika e ndezjes	Gradë celsius	Mbi 55	-	EN ISO 2719
Karboni i mbetur (në 10% mbetje distilati)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Kontaminimi total	mg/kg	-	24	EN 12662
Gërryerja e shiritit bakrit (3 orë në 50 gradë celsius)	Grada	Grupi 1		EN ISO 2160
Përmbajtja e Acidit të ngopur metil ester FAME	% (V/V)	-	7,0	EN 14078
Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m ³ h	- 20	25 -	EN ISO 12205 EN 15751
Lubrifikimi, diametri i veshjes së mprehte (wsd 1,4) në 60 gradë Celsius	µm (micrometer)	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 gradë Celsius	Mm ² /s	2,000	4,500	EN ISO 3104
Distilimi % (V/V) rafinimi në 250 gradë celsius % (V/V) rafinimi në 300 gradë Celsius 95 % (V/V) rafinimi në	% (V/V) % (V/V) Gradë celsius	85	Më pak se 65 360	EN ISO 3405 EN ISO 3924
Shënim: Kërkesat me Bold i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70 /EC (1), duke përfshirë amendamentet 2003/17/EC (2), 2009/30/EC (3) dhe 2011/63/EU (4).				
a. Shih gjithashtu 5.7.1. b. Shih gjithashtu 5.7.4.				

-
- c. Shih gjithashtu 5.7.2.
 - d. Për qëllimet e këtij Standardi Evropian, hidrokarbonet policiklikë aromatikë janë caktuar si përmbajtja totale e hidrokarboneve aromatike më pak se përmbajtja e hidrokarboneve mono-aromatike, të dyja të përcaktuara në EN 12916.
 - e. Shih gjithashtu 5.7.3.
 - f. Shih gjithashtu 5.2.2.
 - g. Shih gjithashtu 5.2.2. dhe Aneksi A.
 - h. Investigimi i mëtejshëm për kontaminimin total në metodën e provës për përmirësimin e saktësisë, veçanërisht për prezencën e FAME, nën mbikëqyrjen e CEN.
 - i. FAME i përkojnë kërkesat e EN 14214, shih (3).
 - j. Kur karburantet e naftës përmbajnë më shumë se 2 % (V/V) FAME, qëndrueshmëria e oksidimit e përcaktuar në EN 15751 është kërkesa për të.
 - k. Për llogaritjen e indeksit të Cetanit 10%, 50 % dhe 90% (V/V) nevojiten gjithashtu pikat e RECOVERY.
 - l. Limitet e distilimit në 250 gradë Celsius dhe 350 gradë Celsius janë përfshirë në tarifën e karburantit naftë të Doganave të përbashkëta të BE.
 - m. EN ISO 3924 jep instruksione për konvertimin në ISO 3405-të dhëna ekuivalente. Shih gjithashtu 5.7.5.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Loti i II-të “Blerje benzinë për automjete”,

BENZINË PA PLUMB AL ST EN 228:2012 + A1 :2017 (E)

15367, Pjesët 2 dhe 3 respektivisht (7,8). Një metodë përcaktimi për komponentët me zierje të lartë në benzinën pa plumb është nën zhvillim e sipër nga CEN.

Në vijim, Tabela 2- Kërkesa dhe metoda testi për benzinën pa plumb me përmbajtje oksigjeni maksimum prej 2.7% (m/m)

Vetitë	Njësitë	Kufizimet		Metoda Testi ^a
		Min	Max	
				(Shih 2. Referenca normative)
Numër Oktani Kërkimi, RON		95,0		EN ISO 5164 b
Numër Oktani Makine, MON		85,0		EN ISO 5163 b
Përmbajtje plumbi	Mg/l		5,0	EN 237
Densiteti (në 15°C) c	Kg/m ³	720,0	775,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Përmbajtje Sulfuri c	Mg/kg		10,0	EN ISO 13032 EN ISO 20846 EN ISO 20884
Përmbajtje manganezi d Deri 31-12-2013 Nga 01-01-2014	Mg/l		6,0 2,0	EN 16135 EN 16136
Qëndrueshmëria e oksidimit	Min.	360		EN ISO 7536
Përmbajtja e gomës ekzistente (solvent i larë)	Mg/100ml		5	EN ISO 6246
Rrip korrozioni bakri 3 h në 50 °C	Vlerësim	Klasi 1		EN ISO 2160
Dukshmëria e		I qartë dhe i ndritshëm		Inspektim vizual
- Përmbajtja e tipit të hidrokarbonit c - Olefinë - Aromatik	% (V/V)		18,0 35,0	EN 15553 EN ISO 228 54
Përmbajtja e benzolit c	% (V/V)		1,00	EN 238 EN 12177 EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenit c	% (m/m)		2,7	EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854

Përmbajtja e oksigjenatit c	% (V/V)			EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854
<ul style="list-style-type: none"> - Methanol - Etanol g 			3,0 5,0	
<ul style="list-style-type: none"> - Alkool Iso-propil h - Alkol Iso-butyl h - Alkool Tert-butyl h - Eterë (5 ose më shumë atome C) h - Oksigjenate të tjera hi 			Përzierje volumi e kufizuar në 2.7% (m/m) përmbajtja max. e oksigjenit	
SHËNIM: Kërkesat e theksuara me bold i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4)				
<p>(a) Shih gjithashtu 5.7.1</p> <p>(b) një korrektrim i 0,2 për MON dhe RON do të zbritet për përlogaritjen e rezultatit final përpara raportimit sipas kërkesës së Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4). Shih gjithashtu 5.6 dhe 5.7.2</p> <p>(c) Shih gjithashtu 5.7.2</p> <p>(d) Shih gjithashtu 5.3.3</p> <p>(e) Dukshmëria do të përcaktohet në temperaturë ambienti</p> <p>(f) Do të shtohen agjentë stabilizues</p> <p>(g) Kur përdoret etanoli si komponent përzierjeje do të bëhet në përshtatje me EN 15376 (Shih 5.1). Agjentë stabilizues mund të shtohen.</p> <p>(h) Përmbajtja e oksigjenit të benzinës së pastër pa plumb nuk do të kapërcej 2,7% (m/m). Një CEN/TR mbi përzierjen oksigjenate është në përgatitje e sipër.</p> <p>(i) të tjera monoalkoolike dhe eterë me një pikë zierjeje të fundit jo më të lartë se sa përshkruhet në Tabelën 4</p>				

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

340,000 litra Gazoil (Nafte)

84,000 litra Benzine

Afatet e lëvrimit: lëvrimi i mallit do të kryhet për gjatë gjithë vitit me kërkesë te Autoriteti Kontraktor nepërmjet kartave elektronike të personalizuar. E drejta e Autoritetit Kontraktor për të kërkuar Lëvrimin e mallit do të jetë jo më vonë se 5 ditë kalendarike nga momenti i lidhjes së kontratës, por lëvrimi do të fillojë në përputhje me nevojat e Autoriteti Kontraktor.

Kohëzgjatja e përafërt e kontratës: Lëvrimi i mallit do të kryhet për periudhën 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës. Në rast se fondi i venë në dispozicion nuk shpenzohet brenda këtij afati, afatet e kontrates do të shtyhen deri në ezaurimin e vlerës së plotë të kontratës.

Vendi i dorëzimit: Operatori ekonomik ofertues duhet të ofrojë furnizimin e pandërprerë në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në të gjitha qytetet ku ndodhen autoritet kontraktor, dhe konkretisht - Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Lushnje, Berat, Fier, Vlore, Gjirokaster, Sarandë, Tepelene, Permet, Korce, Pogradec, Kolonje, Elbasan, Librazhd, Shkoder, Koplik, Lezhe, Puke, Burrel, Kurbin, Diber, Mirdite, Kukes, Tropoj dhe Has, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor ose tollona në formë biletash, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

Kriteret kualifikuese për Loti i I-rë: “Blerje gazoil për automjete”;

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënues për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënues ose nuk ka qenë i dënues nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënues me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në masën **1,046,822.36** (një milion e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e njëzet e dy pikë tridhjetë e gjashtë) Lekë.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2018, 2019, 2020) të jetë jo më pak se 99% e vlerës së fondit limit për secilin lot që prokurohet / shumatores së loteve për të cilat konkurren dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ofertues duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë jo më të ulët se 39% të vlerës limit për secilin lot që prokurohet / shumatores së loteve për të cilat konkurren gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar mesektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas adresave të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor, ku Bashkia e Tiranës te këtu minimumi 5 (pesë) stacione, si dhe në të gjitha qytetet ku ndodhen autoritetet kontraktor, dhe konkretisht - **Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Sarandë, Tepelene, Permet, Korçë, Pogradec, Kolonjë, Elbasan, Librazhd, Shkoder, Koplak, Lezhë, Pukë, Burrel, Kurbin, Dibër, Mirditë, Kukës, Tropojë dhe Has**, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (në pronesi ose kontratë noteriale qeraje ose furnizimi (bashkepunimi) ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB,). Këto stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve të cituara më lartë detyrimisht duhen të jenë të pajisur me Licence/Autorizim të lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë, Leje mjedisore e tipit B ose C sipas legjislacionit, të lëshuar nga QKL, Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet deklarojë që stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve ku do të kryhet furnizimi, të cilat janë në marrëveshje me të treta (kontrata furnizimi), të lidhura për këtë qëllim me shoqëri të tjera e cila duhet të garantojë përmbushjen të gjitha kriterëve të vendosura në dokumenta tenderi si dhe detyrimisht të jenë të pajisura me Sistem Elektronik.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësive përgjatë vitit të fundit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Fletë analize të lëshuar nga ISHTI të cilat duhet të jenë lëshuar brenda 30 ditëve nga data e hapjes së ofertave.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targonë e cdo automjeti të autoritetit kontraktor ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasitë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targonë e mjetit në lëng me bot, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Kartë elektronike duhet të jenë pa afat skadencë deri në përfundimin e plotë të kontratës.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nëpërmjet kartëve elektronike të personalizuar, sipas adresave të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.
- Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 **“Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme”**, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojë një faqe menaxhimi të karburanteve

(webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.

- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targonë e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar levizjen e mundshme të targave nga mjetit shtetëror drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me anë të emailit për çdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj.
- Disponimi/Ekzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin e shërbimeve të kërkuara më sipër, do të demonstrohen nga ana e operatoreve ekonomik pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktikë, në prani të anëtarëve të KVO-së së Autoritetit kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.
- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përben kusht për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret kualifikuese për

Loti i II-të “Blerje benzinë për automjete”,

2. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik,

nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në masën **252,625.64** (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë pikë gjashtëdhjetë e katër) **Lekë**.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2018, 2019, 2020) të jetë jo më pak se 99% e vlerës së fondit limit për secilin lot që prokurohet / shumatores së loteve për të cilat konkurren dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ofertues duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë jo më të ulët se 39% të vlerës limit për secilin lot që prokurohet / shumatores së loteve për të cilat konkurren gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar mesektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, ku Bashkia e Tiranës të ketë minimumi 5 (pesë) stacione, si dhe në të gjitha qytetet ku ndodhen autoriteti kontraktor, dhe konkretisht - **Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Tepelene, Permet, Korçë, Pogradec, Kolonjë, Elbasan, Librazhd, Shkoder, Koplik, Lezhë, Pukë, Burrel, Kurbin, Dibër, Mirditë, Kukës, Tropojë dhe Has**, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (në pronësi ose kontratë noteriale qeraje ose furnizimi (bashkëpunimi) ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB,). Këto stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve të cituara me lartë detyrimisht duhen të jenë të pajisur me Licence/Autorizim të lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë, Leje mjedisore e tipit B ose C sipas legjislacionit, të lëshuar nga QKL, Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet deklarojë që stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve ku do të kryhet furnizimi, të cilat janë në marrëveshje me të treta (kontrata furnizimi), të lidhura për këtë qëllim me shoqëri të tjera e cila duhet të garantojë përmbushjen të gjitha kriterëve të vendosura në dokumenta tenderi si dhe detyrimisht të jenë të pajisura me Sistem Elektronik.

2.3.8 Subjekti ofertues duhet te paraqese nje vertetim te leshuar nga ISHTI, qe vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete per shkelje te cilesise përgjatë vitit të fundit.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Flete analiza të lëshuar nga ISHTI te cilat duhet të jenë lëshuar brenda 30 diteve nga data e hapjes së ofertave.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me karte elektronike te personalizuar me targon e cdo automjeti te autoritetit kontraktor ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasine e litrave te ndodhura ne karten elektronike te personalizuar me targon e mjetit në lëng me bot, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktore. Karta elektronike duhet të jenë pa afat skadencë deri ne përfundimin e plotë të kontrates.
- Operatori ekonomik duhet te mbuloje furnizimin nepermjet karteve elektronike te personalizuara, sipas adresave te kerkuara nga Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar ne VKM Nr 561 date 29.07.2016 **“Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem“**, Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepemjet kartes elektronike.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit te sasisë se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit, si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet te ofroje edhe mundesine e afishimit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve duhet te ofroje edhe sherbimin per krijimin e struktures piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit kontraktor, sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), te cilat ngjiten ne xhamin e automjetit dhe ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate automjet per te eliminuar levizjen e mundshme te targave nga mjetit shteteror drejt mjeteve private, si dhe sherbimin e dergimit te fotografive me ane te emailit per cdo furnizim te kryer te mjetit prane stacionit te shitjes se karburanteve me pakice me qellim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit te saj .
- Disponimi/Ekzistenca e faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), se bashku me ofrimin sherbimeve te kerkuara mesiper, do te demonstrohen nga ana e operatoreve ekonomik pjesemarres me shembuj per zbatimin ne praktike, ne prani anetareve te KVO-se se Autoritetit kontraktor perpara mbylljes se procesit te kualifikimit dhe shpalljes se fituesit.

-
- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mesipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përben kusht për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim:

1. Sasitë e kërkuara nga AK, janë sasi të pritshme, e llogaritur në bazë të cmimit mesatar për litër nëpërmjet studimit të tregut. Kjo sasi mund të jetë e ndryshueshme në varësi të cmimit të publikuar nga APP në buletin javor.

2. Do të jetë AK ajo që do të përcaktojë sasi të përkatëse gjatë zbatimit të kontratës. Operatorët do të ofertojnë me marzh fitimi në lek për litër. Ky marzh fitimi do të jetë i pandryshuar gjatë gjithë realizimit të kontratave. Sasia e kërkuar nga autoriteti është sasi e pritshme, për të cilën autoriteti do të shprehet në momentin e nënshkrimit të kontratës.

2.1. Perlllogaritja e cmimit do të përfshijë element si më poshtë:

- a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletin e Njoftime Publike;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.”

Sqarim! Të gjitha kriteret e sipërcituara në **Shtojca 7, të DST-së**, të cilat përfshihen në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas **Shtojca 9, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura në fazën e vlerësimit të ofertave të ofertuara në SPE.***”

Referuar përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 të ndryshuar me VKM-në Nr. 710, date 24.11.2021, ku parashikohet: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, **Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.***”

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

• **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

